

Statistikat mbi Shkaqet e Vdekjeve

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Aida Boduri
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	aboduri@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	20/05/2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	21/05/2020
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	20/05/2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi Shkaqet e vdekjeve përmbajnë të dhëna për vdekjet e regjistruara në një vit të dhënë në Shqipëri. Këto statistika analizohen dhe publikohen duke u bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, ICD-9, në përputhje të plotë me organizatën Botërore të Shëndetësisë OBSH.</p> <p>Sipas klasifikimit ICD-9 të gjitha sëmundjet kodohen nga 1-999 dhe grupohen në 17 grupsëmundje kryesore. Grupimet e vdekjeve bëhen dhe sipas shkakut të vdekjes (natyror, vrasje, vetëvrasje, aksidente etj.), sipas grupmoshës, qarkut si dhe shkaqet e grupuara sipas vendndodhjes (shtëpi, institucion shëndetësor ose tjetër). Për analiza më të detajuara, duke u bazuar dhe në kërkesat e përdoruesve të ndryshëm, klasifikim i shkakut të vdekjeve bëhet edhe sipas nëngrupeve apo sëmundjeve specifike, peshë e të cilave është e lartë në vdekjet gjithsej gjatë një viti të caktuar. Këto statistika janë të rëndësishme për përdoruesit për studime dhe identifikime të rasteve të shpeshta, dhe janë përbëjnë rëndësi për politikën shëndetësore parandaluese të sëmundshmërisë.</p>

<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Në përpunimin e të dhënave dhe llogaritjen e treguesve të shkakut të vdekjeve, INSTAT përdor Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Shkaqeve të Vdekjeve dhe Traumave (ICD-9).</p> <p>Grupsëmundjet kryesore sipas (ICD-9) konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> I. Sëmundjet infektive dhe parazitare (001-139) II. Tumoret (140-239) III. Sëmundjet endokrine, të ushqyerit, të metabolizmit dhe turbullimet (240-279) IV. Sëmundjet e gjakut dhe të organeve formuese të gjakut (Hemopoetike) (280-289) V. Sëmundje mendore (290-319) VI. Sëmundje të sistemit nervor qëndror dhe të organeve të shqisave (320-389) VII. Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut (390-459) VIII. Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes (460-519) IX. Sëmundje të aparatit të tretjes (520-579) X. Sëmundje të aparatit urogjenital (580-629) XI. Ndërlikime të barrës, të lindjes dhe të periudhës pas lindjes (630-676) XII. Sëmundje të lëkurës dhe indit qelizor në lëkurë (680-709) XIII. Sëmundje të sistemit të kockave dhe të kyçeve, të muskujve (710-739) XIV. Anomali (Keqformime) të bashkëlindura (Kongenitale) (740-759) XV. Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes (perinatale) (760-779) XVI. Simptoma, shënja dhe sëmundje të pa përcaktuara mirë (780-799) XVII. Dëmtime traumatike dhe helmime (800-999) XVIII. Klasifikimi suplementar i shkaqeve të jashtme të traumave (E800-E999) dhe të helmimeve. <p>Ky klasifikim është i aksesueshem në shqip në linkun ICD-9.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhënat mbi shkaqet e vdekjeve, të cilat prodhohen në nivel të detajuar lidhur me numrin e vdekjeve sipas grupsëmundjeve kryesore, sipas gjinisë, grupmoshës dhe qarqeve. Gjithashtu përfshihen edhe statistika sipas shkakut të vdekjeve dhe vendit të ndodhjes së vdekjes.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Shkaku i Vdekjeve: Është sëmundje, simptoma sëmundjeje ose trauma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit ose të dhunës që</p>

	<p>kanë shkaktuar këto trauma.</p> <p>Vdekja: Nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi reanimimi). Ky definicion nuk përmban vdekjen fetale.</p> <p>Vdekja Amtare: Është vdekja e një gruaje që ndodh gjatë periudhës së shtatzënisë ose brenda 42 ditëve mbas përfundimit të saj, cilado të jetë zgjatja ose lokalizimi, nga një shkak çfarëdo i përcaktuar ose i rënduar nga barra ose nga ndihma e dhënë për barrën, por jo aksidentale dhe as e papritur.</p> <p>Vdekshmëria: Shpreh vdekjet si komponent i ndryshimit të popullsisë.</p> <p>Koeficienti i Vdekshmërisë (ose koeficienti bruto i vdekshmërisë): Është numri i vdekjeve për 1.000 banorë në një vit të dhënë.</p> <p>Koeficienti i Vdekshmërisë Amtare: Është numri i vdekjeve të grave për shkak të shtatzënisë ose komplikacioneve gjatë lindjes për 1.000 lindje të gjalla të atij viti.</p> <p>Koeficienti i Vdekshmërisë Foshnjore (IMR): Është numri i vdekjeve të fëmijëve të moshës nën një vjeç në një vit të dhënë për 1.000 lindje të gjalla të atij viti.</p> <p>Koeficienti i Vdekshmërisë Neonatale: Është numri i vdekjeve të fëmijëve nën 28 ditë në një vit të dhënë për 1.000 lindje të gjalla të atij viti.</p> <p>Koeficienti i Vdekshmërisë Perinatale: Është numri i vdekjeve fetale të fëmijëve nën 28 javë shtatzënie (vdekje fetale të vona) plus numrin e vdekjeve të fëmijëve nën 7 ditë për 1.000 lindje të gjalla të atij viti.</p> <p>Koeficienti specifik i vdekshmërisë: Koeficientet e vdekshmërisë mund të llogariten për grupmosha specifike për të krahasuar vdekshmërinë në moshë të ndryshme ose ndryshimin në vdekshmëri për të njëjtën moshë gjatë kohës. Krahasime mund të bëhen edhe ndërmjet vendeve.</p> <p>Koeficienti specifik i vdekshmërisë sipas shkakut: Çdo vdekje ka një shkak, të paktën për qëllime statistikore madje edhe nëse ai shkak është “i pa njohur”. Koeficientet bazë të vdekshmërisë sipas shkakut zakonisht shprehen në vdekje për 100.000 banorë sepse për shumë shkaqe vdekjesh shkalla e ndodhjes është shumë e vogël.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore konsiderohet numri i vdekjeve të popullsisë në një vit të dhënë, sipas shkakut të vdekjes, shkaku i vdekjes sipas vendndodhjes (shtëpi, institucion shëndetësor, tjetër), shkakut që e shkakton vdekjen (natyror, vrasje, vetëvrasje, aksidente).
3.6. Popullata statistikore	Për statistikat e shkaqeve të vdekjeve, INSTAT përpunon të dhënat mbi vdekjet e rezidentëve në Shqipëri, të cilat sigurohen nga aktet e vdekjeve të gjeneruara nga skeda e plotësuar nga Mjeku. Këto të dhëna sigurohen nga Drejtoria e Gjendjes Civile.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat mbi statistikat e shkaqeve të vdekjeve mbulojnë gjithë territorin e vendit. Të dhënat e agreguara janë në nivel vendi dhe në nivel qarku.

3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat për shkaqet e vdekjeve janë të disponueshme nga viti 2012.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Në statistikat e shkaqeve të vdekjeve njësia kryesore matëse janë numrat absolut, përqindjet, vdekje bruto.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve është vjetore. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve janë bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT nuk transmeton tregues në EUROSTAT në lidhje me Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Të dhënat publikohen në nivel të agreguar. Të dhënat nuk publikohen asnjëherë në nivel individual.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.

8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – press release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimet e Shëndetësisë 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Shpërndarja e të dhënave të statistikave të shkaqeve të vdekjeve bëhet në baza vjetore përmes botimeve të përmendura më lart.
10. Akses i të dhënave dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve për treguesit kryesorë të analizuar dhe publikuar. Njoftimi për shtyp i Statistikave të Shëndetësisë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT nën temën Shëndetësia .
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet mbi Statistikat e Shëndetësisë në faqen e internetit të INSTAT të organizuara si më poshtë:</p> <p>Vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2020, • Shqipëria në Shifra, 2019 • Vjetari statistikor, • Vjetari Rajonal Statistikor, 2020 <p>Botim i dedikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin Databaza .
10.4. Akses i të dhënave mikro	Të dhënat e statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk konsiderohen konfidenciale apo çenojë

	konfidencialitetin bazuar në nenin 31, Ligji Nr.17/2018 për Statistikat Zyrtare.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve të dedikuar për këto statistika. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë mbi Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale dokumenton të gjithë proceset dhe procedurat e punës për përdorim të brendshëm.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve është burim administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Institucionet e Administratës Publike; ○ Universitetet; ○ Bizneset, ○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; ○ Organizata kombëtare jofitimprurëse;

	<ul style="list-style-type: none"> • Përdoruesit e brendshëm janë sektorët brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve si input për punën e tyre. <p>Qëllimi kryesor i prodhimit të Statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve është sigurimi i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për nevojat e publikut lidhur me to si dhe për studime dhe raporte shëndetësore.</p>						
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Shëndetësinë për vitin 2020 janë rreth 10,301 klikime.</p> <p>Gjatë 2020, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Shëndetësisë është vlerësuar me 3.63 (72.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>						
12.3. Plotshmëria	<p>INSTAT realizon prodhimin e Statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve në përputhje të plotë me Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Shkaqeve të Vdekjeve dhe Traumave (ICD-9).</p>						
13. Saktësia dhe besueshmëria							
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Informacioni mbi “Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve” grumbullohet nga burimet administrative, dhe të dhënat janë finale.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo kampionimit trajtohen bazuar në Politikën e Trajtimit të Gabimeve.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet në lidhje me Shkaqet e Vdekjeve publikohen 140 ditë pas vitit referencë (T+140 ditë), në përputhje me kalendarin e publikimeve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/20/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>140</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	5/20/2021	Afatet kohore	140
Periudha referuese	12/31/2020						
Data e publikimit	5/20/2021						
Afatet kohore	140						

14.2. Përpikmëria	<p>Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave të Shkaqeve të Vdekjeve si pjese e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="432 309 874 472"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>5/20/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/20/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	5/20/2021	Data e publikimit	5/20/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	5/20/2021								
Data e publikimit	5/20/2021								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi dhe qarku.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e Shkakut të vdekjes datojnë që nga viti 1993, ka një shkëputje nga viti 2009-2011. Nga viti 2012 – 2020 të dhënat janë publikuar në web-in dhe databazën e INSTAT, duke siguruar nje krahasueshmeri kohore prej 9 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=9).								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.								
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve pranë sektorit të Zhvillimit të Statistikave Sociale është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.								
17. Rishikimi i të dhënave									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të Statistikave të Shkaqeve të Vdekjeve bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. E njëjta politikë e rishikimit zbatohet edhe në transmetimet në Eurostat. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e Trajtimit te Gabimeve 								
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se institucionet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi shkaqet e vdekjeve raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.								

18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Institucioni kryesor që shërben si burim informacioni për statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve është Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Ky burim përbën rëndësi për ecurinë e punës dhe për plotësimin e afateve të përcaktuara kohore.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat në lidhje me statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve janë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe përfshijnë të dhëna mbi vdekjet e regjistruara gjatë një viti në Shqipëri, informacioni i cili bazohet mbi skedat e vdekjeve të plotësuara nga mjeku.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrollet logjike dhe matematikore aplikohen në të dhënat e shkaqeve të vdekjeve. Me metoda të verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Mbulimi është gjithëpërfshirës në nivel vendi dhe qarku, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet përherë në kohë, prandaj vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	